

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje adezive per kazane dhe kamione”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 39294100-0

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 6.376.867 (gjashtë milion e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë ) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Eco Tirana sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesat e mesiperme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertes është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, si një mjet garancie për Autoritetin Kontraktor në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

2.1.1. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë elektronikisht Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të LPP “Për Prokurimin Publik”

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Kërkesa e vlerës është përcaktuar bazuar në nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 pika 4 gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 55, pika 4 ku është përcaktuar që shërbimet /furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

---

## **2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

2.4.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar.

Ne çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin për ofrimin e pajisjeve objekt të kësaj procedure. Autorizimi nga Prodhuesi duhet të përmbajë kontaktet e plota të prodhuesit (adresë, telefon, e-mail) në rast verifikimi.

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do të dorëzojë dhe do të kryejë vendosjen e mallit sipas kërkesës pjesore nga Autoriteti Kontraktor për vendosjen e tyre dhe se adezivet duhet të jenë me karakteristikën e cast të pershtatshme për t'u vendosur në kazane metalike, sipas teknologjisë Print & Cut dhe me karakteristikat si më poshtë:

Fuqia e ngjitesit jo më pak se 15N/25mm

Rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe agjenteve të pastrimit.

2.4.3. Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese Certifikate ISO 9001:2015 në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalent. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues te njohur nga RSH.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet te paraqese moster sipas specifikimeve teknike te cilesuara nga Autoriteti Kontraktor ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave per artikujt e meposhtem:  
- Adezive per kazan Blu  
- Adezive per kazan 3750lt teknologjia e re  
Mostrat e paraqitura duhet te perputhen me specifikimet teknike sipas Shtojces 5 dhe 6. Mosparaqitja ose mosperputhja e mostrave eshte kusht s'kualifikimi.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 40 pikës 6, gërma a dhe pika 8 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe nenit 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga Eco Tirana sh.a. duke iu referuar mallrave dhe furnizimeve te meparshme,adeziveve aktuale të vendosur në mjete dhe kazanë, kërkesave dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor Eco Tirana sh.a. në fushën e veprimtarisë së tij.

Ne dokumentat e tenderit AK ka ngarkuar foto ilustruese.